



**REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në bazë të nenit 4 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën për financim, krijim dhe përkryerje të kuadrove shkencoro-hulumtuese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.82/09), Ministria e arsimit dhe shkencës publikon

**K O N K U R S
PËR NDARJE TË BURSIVE TË CIKLIT TË DYTË NË VEND PËR VITIN AKADEMIK 2009/2010**

1. Bursat për studimet të ciklit të dytë do të ndahen për sferat shkencore në vijim:

- shkencat matematiko-natyrore dhe tekniko-teknologjike.....	80 poena
- shkencat bioteknike, mjekësore dhe shëndetësi.....	40 poena
- shkencat shoqërore dhe humanitar.e.....	30 poena

Kandidatët që do të konkurojnë duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- të kenë mbaruar studimet akademike të ciklit të parë në kohëzgjatje prej tri, gjegjësisht katër vite dhe arritje të suksesit mesatar prej më së paku 8,50;
- të jenë të regjistruar në studime të ciklit të dytë për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2009/2010;
- të jenë të regjistruar për herë të parë në vitin e dytë në vitin akademik 2009/2010 dhe të kenë fituar më së paku 2/3 të kredive të parapara sipas EKTC sistemit;
- programi studiues në të cilën janë të regjistruar kandidatët të jetë i akredituar dhe të ketë vendim për punë;
- në ditën e konkurimit të mos jenë më të moshuar se 27 për vitin e parë, gjegjësisht 28 vjet për vitin e dytë;
- të mos jenë në marrëdhënie pune (në kohë të caktuar ose të pacaktuar pune);
- të njohin një nga gjuhët e huaja botërore;
- të mos jenë shfrytëzues të bursës ose donatorëve tjerë;
- të njohin punën me kompjuter;

DOKUMENTET E DUHURA:

- diplomë për mbarimin e studimeve akademike të ciklit të parë dhe certifikatë për suksesin e arritur;
- vërtetim nga fakulteti-instituti se kandidati është për herë të parë i regjistruar në semestrin e parë ose të dytë të studimeve të ciklit të dytë në vitin akademik 2009/2010, prej kur fillon semestri dhe sa semestra zgjasin studimet;
- vërtetim nga fakulteti-instituti se në vitin akademik 2009/2010 është i regjistruar për herë të parë në semestrin e tretë të studimeve në ciklin e dytë dhe certifikatë për kredi të parapara dhe të dhëna sipas EKTC sistemit (vlen për personat të cilët do të konkurojnë për herë të parë për vitin e dytë të studimeve të ciklit të dytë);
- certifikatë nga libra amzë e lindjes;
- dëshmi nga institucioni se programi studiues në të cilën është i regjistruar studenti - është i akredituar dhe Vendim për punë;
- vërtetim nga Agjencia për punësim të RM se kandidati nuk është në marrëdhënie pune (në kohë të caktuar ose të pacaktuar);
- diplomë ose certifikatë për njohjen e një gjuhe të huaj botërore;
- deklaratë me shkrim se nuk është shfrytëzues të bursës për studimet të ciklit të dytë nga donatorë tjerë (e vulosur te noteri);
- dëshmi se ka njohuri në punë me kompjuter.

2. Dokumentet të cilat jepen nga institucionet nga vendet tjera duhet të jenë të përkthyer prej përkthyesit të autorizuar gjyqësor.

3. Dokumentet e duhura për ndarje të bursës për studime të ciklit të dytë në vend dhe jashtë vendit mundë të dorëzohen në origjinal ose kopje e vulosur te noteri.

4. Afati për paraqitje të kandidatëve për shfrytëzim të bursave për studime të ciklit të dytë është 30 ditë nga dita e publikimit të konkursit. Dokumentet e duhura nga Konkursi, dorëzohen në veçanti personalisht në Ministrinë e arsimit dhe shkencës. Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet të dorëzuara pas skadimit të afatit nuk do të pranohen. Fletëparaqitjet në konkurs me udhëzimin për dokumentacionin e duhur i cili duhet të dorëzohet në lidhje me konkursin, personat e interesuar mundë të ngritin në Ministrinë për arsim dhe shkencë ose në Veb faqen e MASH www.mon.gov.mk

Ministria e arsimit dhe shkencës

Rr."Mito Haxhivasiliev Jasmin"pa nr. (Ndërtesa Nova Makedonija kati 14) 1000 Shkup.

Informatat për kushtet dhe kriteret ndër të cilat do të ndahen bursat mundë të merren në Ministrinë e arsimit dhe shkencës ose në telefon 3140-183.